EMRAT/ 25-vjeçari i dehur plagosi me armë shokun dhe më pas veten teksa festonin ditëlindjen, arrestohet autori dhe dy persona të tjerë

11 Dhjetor, 2022 09:15

Madhësia e tekstit:

Të shtëna me armë janë regjistruar në Tapizë. Mësohet se një person në gjendje të dehur ka plagosur me armë zjarri shokun e tij dhe më pas veten. Të rinjtë mësohet se kanë qenë duke festuar një ditëlindje, por situata ka dalë jashtë kontrollit.

Policia bën me dije se pas ngjarjes është vënë në pranga autori 25-vjeçar, si dhe pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për prishje të vendit të ngjarjes dhe fshehje të provave, dhe një tjetër person, shok i të plagosurve, për moskallëzim krimi.

Të arrestuarit janë identifikuar si Xhentil Sefa, autori, Hygert Muja, pronari i lokalit dhe Flogert Kallari, miku i dy të plagosurve.

Njoftimi i policisë:

Plagosi me armë zjarri, një shtetas (shok i tij) dhe më pas veten, vihet në pranga 25-vjeçari. Në pranga edhe pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për prishje të vendit të ngjarjes dhe fshehje të provave.

Arrestohet edhe një shtetas tjetër (shok i shtetasve të plagosur), për moskallëzim të krimit. Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale, arma e zjarrit pistoletë me të cilën u krye plagosja. Specialistët për Hetimin e Krimit të Komisariatit të Policisë Krujë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Xh. S., 25 vjeç, për veprat penale "Vrasja", mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit luftarak".

Gjithashtu, u arrestua në flagrancë shtetasi H. M., 24 vjeç, pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

Në vijim të veprimeve u arrestua në flagrancë edhe shtetasi: F. K., 28 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Nga veprimet e para hetimore të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Krujë, rezulton se këta shtetas ishin ulur së bashku në të njëjtën tavolinë, në lokalin e shtetasit H. M., në Qerek Tapizë.

Dyshohet se në gjendje të dehur, shtetasi Xh. S., ka nxjerrë një armë zjarri pistoletë dhe në rrethana ende të paqarta, ka plagosur shtetasin L. C. (shok i tij) dhe më pas është vetëplagosur në dorë. Të dy shtetasit e plagosur janë jashtë rrezikut për jetën.

Po nga veprimet hetimore rezultoi se shtetasi H. M., pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, ka fshehur armën e krimit, ka hequr gëzohjat nga vendngjarja dhe ka prishur vendin e ngjarjes. Gurpi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Tentoi të kalojë kufirin me 20 mijë paund të padeklaruara, arrestohet në Morinë 22-vjeçari që vinte nga Prishtina
11 Dhjetor, 2022

"Pashë një vajzë që vdiq në vend", tragjedia në Itali ndodhi në një agjencë menaxhimi pronash, flasin dëshmitarët: Shpëtova se u futa poshtë tavolinës
11 Dhjetor, 2022

Taboola Feed

Unsold 2020 SUVS In Paskuqan Are Almost Being Given Away
90% discount is available for this month (More Details)
Unsold SUV | Search AD | Sponsored
Search Now

Meet Single Woman From Paskuqan
What are you waiting for? Get your life partner today
Online Dating | Search Ads | Sponsored
Search Now

"Nëse Kroacia fiton Botërorin...", premtimi "i çmendur" i Ivana Knoll
"Nëse Kroacia fiton Botërorin...", premtimi "i çmendur" i Ivana Knoll
balkanweb.com

Find Out Which Dating Site Is Most Effective In Paskuqan
Your life partner is just a few clicks away
Dating Over 50 | Search Ads | Sponsored
Search Now

TË FUNDIT NGA KRONIKË

Tentuan të largohen drejt Gjermanisë me dokumente të falsifikuara, arrestohen në Rinas 3 të rinj nga Kosova
11 Dhjetor, 2022

E akuzuar për korrupsion dhe ryshfet prej 131 mijë eurosh, lihet në burg ish-drejtoresha në OSHEE
11 Dhjetor, 2022

Rrëshqitje dheu në Murriz, bllokohetruga e Arbrit, drejtuesit e mjetève prej disa orësh në pritje
11 Dhjetor, 2022

Reshjet e shiut shkaktojnë probleme edhe në qarkun e Gjirokastrës, bllokohet truga që të çon në fshatrat e Kurvelesit
11 Dhjetor, 2022

Shpërthen në flakë kabina elektrike në Lazarat, mbetet pa energjí gjysma e fshatit
11 Dhjetor, 2022

Trazira në burgun e Korydallos, shqiptari dhe miku i tij presin kanxjellat e qelisë dhe tentojnë të arratisen
11 Dhjetor, 2022

KATEGORIA VIDEO

Video/ SHIBA, alarm për bombë në teatër, momenti në të cilin Patti LaBelle tërhiqet me forcë
11 Dhjetor, 2022

"Korrupsioni gërryen potencialin e Shqipërisë", ambasadorja Kim: Presim një tepër arritje gjatë viit 2023 nga SPAK
11 Dhjetor, 2022

Ceremonia e 32-vjetorit të PD/ Alibeaj: Do mbetemi parti e vlerave anti-komuniste, nuk bëjmë negociata për to
11 Dhjetor, 2022

E akuzuar për korrupsion dhe ryshfet prej 131 mijë eurosh, lihet në burg ish-drejtoresha në OSHEE
11 Dhjetor, 2022

EULEX u sulmua me bombë molotov, reagon ambasadori amerikan në Kosovë: Akt i paparashikuar
11 Dhjetor, 2022

Rrëshqitje dheu në Murriz, bllokohet truga e Arbrit, drejtuesit e mjetève prej disa orësh në pritje
11 Dhjetor, 2022

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Tentoi të kalojë kufirin me 20 mijë paund të padeklaruara, arrestohet në Morinë 22-vjeçari që vinte nga Prishtina
11 Dhjetor, 2022

"Pashë një vajzë që vdiq në vend", tragjedia në Itali ndodhi në një agjencë menaxhimi pronash, flasin dëshmitarët: Shpëtova se u futa poshtë tavolinës
11 Dhjetor, 2022

Reshjet në vend/ Deputeti i PD: Gjirokastra pa energji elektrike, pasojë e braktisjes së qëllimshme nga shteti
11 Dhjetor, 2022

'Kjo është gjyhja Diana', Meghan Markle i tregon djalit foton e princeshës së ndjerë, Princi Harry dhe gruaja e tij flasin për Lady D në dokumentarin në Netflix
11 Dhjetor, 2022

Situata me reshjet/ Vasili: Fshatrat e Krujës u përmbytën pas hapjes si portave në Ibovilë
11 Dhjetor, 2022

Tragjedi në Itali/ "Do u vras të gjithë", ekzekutohen brenda një agjencie imobiliare 3 pra dhe plagosen 4 persona të tjerë
11 Dhjetor, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2022 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.